



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____. _____. 2025

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: **Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE): “EN-SAL” sh.p.k. & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” sh.p.k.** dhe me adresë:

“EN-SAL” sh.p.k., me nipt: K83520201V, do të realizojë 3.4 % të punimeve dhe me adresë: Vidhas, Papër, Zona Kadastrale Nr. 3764, Numri i Pasurise 52/26/5, Elbasan

“ALKO IMPEX CONSTRUCTION” sh.p.k., me nipt: K91628013D, do të realizojë 96.6 % të punimeve dhe me adresë: Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Asim Vokshi", Alb building 2t, kati i 2, Tiranë.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ **JO** ☐

Nëse po, të jepen dhënat: ALKO-IMPEX General Construcion dshh me nipt: K91326028I dhe me adresë: Rruga Reshit Petrela, Kompleksi, Usluga, kati i 8, prane stacionit te trenit, Tiranë është OE mbështetës i OE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” sh.p.k

Tipi i Kontratës: Punë

Procedura e prokurimit: **“Proçedurë e hapur”**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF- 62416-09-23-2025

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "**Rikonstrukcion i rrugës "Kryezjarr", Njësia Administrative Shirgjan, Elbasan**", me fond limit **18,524,808** (tetëmbëdhjetëmilion e pesëqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e tetë) **lekë pa t.v.sh.**, vene ne dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2025 dhe 2026, me afat 3 muaj për kryerjen e punimeve.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 27.11.2025

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit 02.12.2025, Buletini Nr.75

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "BLERIMI" sh.p.k. me Nipt: J 62903384 G

(Me operator mbështetes: "RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN" sh.a me nipt: J62904264O, me adrese: Fshati Balëz Poshte, Njesia administrative Bradashesh, Elbasan është O.E mbështetës i O.E "BLERIMI" sh.p.k me Nipt: J 62903384 G)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **15,004,216** (pesëmbëdhjetëmilion e katërmije e dyqind e gjashtëmbëdhjete) **lekë (pa tvsh)**.

2. "BAJRAMI N." sh.p.k. me Nipt: K 02727202 O

(Me operator mbështetes: "C O L O M B O" sh.p.k me Nipt: J82916489E, me adrese: Lagjja "Kryengritja e Fierit, "Rruga "Vangjel Rushku", Godina nr.67, Fier, është O.E mbështetës i O.E "BAJRAMI N." sh.p.k me Nipt: K 02727202 O)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **17,574,128.83** (shtatembdhjetemilion e peseqind e shtatedhjetë e katërmije e njëqind e njëzet e tete presje tetedhjetë e tre) **lekë (pa tvsh)**.

3. “BAMI HOLDING” sh.p.k. me Nipt: J 94416206 R

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **16,292,140.28** (gjashtembdhjetemilion e dyqind e nentedhjetë e dymije e njëqind e dyzet presje njëzet e tete) **lekë (pa tvsh)**.

4. BOE “EN-SAL” sh.p.k. me nipt: K 83520201 V & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” sh.p.k. me nipt: K 91628013 D

(Me operator mbështetës: “ALKO-IMPEX General Construcion” dshh me nipt: K91326028I me adresë: Rruga “Reshit Petrela”, Kompleksi, Usluga, kati i 8, prane stacionit te trenit, Tiranë është OE mbështetës i OE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” sh.p.k me nipt: K91628013D)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **17,867,843** (shtatembdhjetemilion e teteqind e gjashtedhjetë e shtatëmije e teteqind e dyzet e tre) **lekë (pa tvsh)**.

5. “FLED” sh.p.k. me nipt: K 17621104 C

(Me operator mbështetës: “BESTA” sh.p.k. me nipt: J62903182B me adresë: Ura Vajgurore Njësia Administrative, Poshnje, Ndërtesë dy katëshe, kati i dytë, Zona kadastrale 3032, Pasuria Nr.326/20, Berat është OE mbështetës i OE “FLED” sh.p.k me nipt: K 17621104 C)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **14,698,192.70** (katërmbedhjetemilion e gjashtëqind e nentedhjetë e tetemije e njëqind e nentedhjetë e dy presje shtatedhjetë) **lekë (pa tvsh)**.

6. “RSM COMPANY” sh.p.k. me nipt: L04803001U

(Me operator mbështetes: “AVDULI” sh.p.k. me nipt: J66703306O me adresë: Lagjja 10 Korriku, Rruga Perlat, Rexhepi, Objekt 3-katesh nr.4, Kati 1, Vlorë është OE mbështetës i OE “RSM COMPANY” sh.p.k me nipt: L04803001U)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **13,373,190.4** (trembedhjetemilion e treqind e shtatedhjetë e tremije e njëqind e nentedhjetë presje kater) **lekë (pa tvsh).**

7. “2 N” sh.p.k. me nipt: L 31615017 L

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **13,400,003** (trembedhjetemilion e katerqindmije e tre) **lekë (pa tvsh).**

8. “XHASt” sh.p.k. me nipt: K 12512837 I

(Me operator mbështetes: “MELA.” sh.p.k. me nipt: K62320011G me adresë: Rruga “Maliq Muco”, Ndertesa 6, Hyrja 4, Ap.14, Njesia Bashkiake 9, Kodi Postar 1016, Tirane është OE mbështetës i OE “XHASt” sh.p.k K 12512837 I)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **15,296,921.40** (pesembedhjetemilion e dyqind e nentedhjetë e gjashtemije e nenteqind e njëzet e një presje dyzet) **lekë (pa tvsh).**

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “RSM COMPANY” sh.p.k. me nipt: L04803001U

2. (Me operator mbështetes: “AVDULI” sh.p.k. me nipt: J66703306O me adresë: Lagjja 10 Korriku, Rruga Perlat, Rexhepi, Objekt 3-katesh nr.4, Kati 1, Vlorë është OE mbështetës i OE “RSM COMPANY” sh.p.k me nipt: L04803001U)

1. Keni deklaruar se keni marre me kapacitet mbeshtetes nga subjekti “Avduli” shpk, nder te tjera edhe linje inertesh. Nga deklarimi i subjektit “Avduli” shpk, si subjekt mbeshtetes, ne shtojcen 8 “Formulari permbledhese i vetedeklarimit” rezulton se linja e inerteve disponohet sipas kontrates nr.Rep. 973, nr.Kol. 379 me afat nga data 18 shtator 2023 – 17 shtator 2025. Pra, kesaj kontrate ne momenti e shpalljes se procedures ne SPE, date 14.09.2025, i ka mbaruar afati i vlefshmerise, duke mos permblushur keshtu kerkesat e percaktuara ne piken 2.3.10 te kriterave te vecanta, kapaciteti teknik.

2. Keni paraqitur kontraten e ngjashme me objekt: “Ndertimi dhe asfaltimi i rrugeve ne Rugove”, lidhur midis subjektit tuaj dhe Komunes se Pejes, Republika e Kosoves. Bashkangjitur kesaj kontrate keni paraqitur edhe deklaraten e meposhteme:

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Une i nenshkruari **Agim Kola** ne cilesine e **Administratorit** te operatorit ekonomik “**RSM COMPANY**” shpk, deklaroj se: 1. Ne Republiken e Kosoves, Autoriteti Kontraktor ne perfundim te kontrates nuk leshon Formular Vleresimi, por ne perfundim te kontrates Autoriteti Kontraktor leshon nje **Reference** e cila eshte analoge me **Formularin e Vleresimit**. 2. Ne Republiken e Kosoves, Autoriteti Kontraktor nuk leshon **Akt Kolaudimi** per objektin dhe **as certifikaten e marrjes ne dorezim te punimeve** por per Aktin e Kolaudimit dhe Certifikaten e marrjes ne dorezim, te punimeve, Autoritetet Kontraktore ne Republiken e Kosoves leshojne dokumentin : **Raport Perfundimtar**. 3. Situacioni perfundimtar sipas legjislacionit te Kosoves perfshin **Fature + Certifikaten e Zhvillimit Financiar te kontrates + Paramasa dhe Paralogaria**. Ne cdo vit pune leshohet nje situacion perfundimtar qe perfshin dokumentat e mesiperme 4. Ne Republiken e Kosoves, ne fazen e tenderimit nuk kerkohet prokure e posacme, por vetem Akt- Marreveshja e bashkepunimit te Operatoreve.

Nga verifikimi i dokumentacionit bashkangjitur nuk rezulton te jete paraqitur as **Reference** e cila eshte analoge me **Formularin e Vleresimit dhe as Raport Perfundimtar**, i cili eshete analog me Aktin e Kolaudimit dhe Certifikaten e marrjes ne dorezim te punimeve, duke mos permblushur keshtu kerkesat e percaktuara ne piken 2.3.1 te kriterave te vecanta, kapaciteti teknik.

3. Nga verifikimi i bere rezultoi qe preventivi i paraqitur nga ana juaj ka nderhyrje ne njesite dhe sasite, duke ndryshuar nga preventivi i Autoritetit Kontraktor e konkretisht:

Ne seksionin II – PUNIME SHITESH, zeri nr.5, Shtrese çakelli mbeturine kave $t=15\text{cm}$, pershapur e ngjeshur me makineri, njesia dhe sasia sipas preventivit te AK eshte 4672 m^2 , nderkohe qe ne preventivin e paraqitur si oferte nga ana juaj njesia dhe sasia eshte ndryshuar ne 700.80 m^3 . Zeri nr.6, Shtrese stabilizator $t=10\text{cm}$, njesia dhe sasia sipas preventivit te AK eshte 3654 m^2 , nderkohe qe ne preventivin e paraqitur si oferte nga ana juaj njesia dhe sasia

është ndryshuar në 365.40 m^3 . Zeri nr.7, Shtrese çakelli $t=10\text{cm}$, makadam, përhapur e ngjeshur me makineri, njësia dhe sasia sipas preventivit të AK është 1168 m^2 , ndërkohe që në preventivin e paraqitur si oferte nga ana juaj njësia dhe sasia është ndryshuar në 116.80 m^3

Për sa me sipër, oferta juaj konsiderohet e parregullt dhe refuzohet.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

2. "FLED" sh.p.k. me nipt: K 17621104 C

(Me operator mbështetës: "BESTA" sh.p.k. me nipt: J62903182B me adresë: Ura Vajgurore Njësia Administrative, Poshnje, Ndërtesë dy katëshe, kati i dytë, Zona kadastrale 3032, Pasuria Nr.326/20, Berat është OE mbështetës i OE "FLED" sh.p.k me nipt: K 17621104 C)

1. Nga verifikimi i bërë rezultoi që preventivi i paraqitur nga ana juaj ka nderhyrje në sasi, duke ndryshuar nga preventivi i Autoritetit Kontraktor e konkretisht:

Në seksionin V – PUNIME BETONI E B/A", zeri nr.11 Mure buto betoni C 12/15, sasia sipas preventivit të AK është 22.8 m^3 , ndërkohe që në preventivin e paraqitur si oferte nga ana juaj kjo sasi është ndryshuar në 228 m^2 .

Sa më sipër, oferta juaj konsiderohet e parregullt dhe refuzohet.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

3. “XHAST” sh.p.k. me nipt: K 12512837 I

(Me operator mbështetes: “MELA.” sh.p.k. me nipt: K62320011G me adresë: Rruga “Maliq Muco”, Ndertesa 6, Hyrja 4, Ap.14, Njesia Bashkiake 9, Kodi Postar 1016, Tirane është OE mbështetës i OE “XHAST” sh.p.k me nipt: K 12512837 I)

1. Ne piken 2.3.5 te kriterëve te vecanta, kapaciteti Teknik, nder te tjera AK ka percaktuar:

Në rast se operatori ekonomik, i disponon mjetet në pronësi, duhet ti ketë drejtuesit e mjeteve (shoferët dhe manovratorët) në listëpagesë për tre muajt e fundit.

Për mjetet, të cilat janë të marra me qira, OE duhet të paraqesë për shoferët dhe manovratorët, kontratën e punës së vlefshme, dëshmi të aftësisë profesionale / leje drejtimi dhe certifikatë e aftësimi profesional sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore, por pa qenë e nevojshme që këta të figurojnë në listëpagesën e OE.

Nga deklarimi i subjektit tuaj në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” keni deklaruar se dispononi në pronësi ndër të tjera edhe mjetet: Grejder dhe Rrul vibrues hekur-gome me kapacitet 8 -12 ton.

Duke qene se këto mjete i keni deklaruar vetëm në pronësi dhe jo me qira, duhet të kishit deklaruar/paraqitur dokumentacion për manovrator buldozerist. i cili duhet të figurojë në listëpagesën e OE për periudhën e kërkuar.

2. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KVO konstaton, se operatori ekonomik “Xhast” shpk ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, shtojcën 9, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për subjektin mbështetës “Mela” shpk, në përmbushje të kriterit 1.a të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Në këtë formular vetëdeklarimi, vërehet se operatori ekonomik “Mela” shpk, për pjesën II “Shkaqet e përjashtimit” në pikën A: “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referues në rubrikat përkatëse, duke mos dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi. Në pikën 1 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë, e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pa vlefshme.

Referuar sa më sipër, operatori ekonomik ankimes nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 9, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e nevojshme për rubrikat e cituara më sipër në këtë vendim sic ky formular parashikon, duke mosplotësuar kështu pikën 1.a të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9. Ky është edhe qëndrimi i mbajtur nga KPP në vendimet e dhëna prej saj. (Vendimi nr.209/2025 datë 07.02.2025 i KPP).

4. “BLERIMI” sh.p.k. me Nipt: J 62903384 G

(Me operator mbështetes: “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.a me nipt: J62904264O, me adrese: Fshati Balëz Poshte, Njesia administrative Bradashesh, Elbasan është O.E mbështetës i O.E “BLERIMI” sh.p.k me Nipt: J 62903384 G)

Operatori ekonomik “BLERIMI” sh.p.k., nuk ka paraqitur dokumentacionin në afatin e kerkuar siç parashikohet në pikën 6, të nenit 26, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar si dhe në parashikimet e nenit 76 pika 3 germa ë) Ligji nr.162 date 23.12.2020 ku ndër të tjera thuhet se autoriteti kontraktor s’kualifikon çdo operator i cili nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, oferta juaj refuzohet.

5. “2 N” sh.p.k. me nipt: L 31615017 L

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertes tuaj KVO vendosi ta kualifikojë atë. Me pas KVO bazuar në Nenin 93 pika 5 Ligjin nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, verifikoi nëse oferta është ose jo me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit, nga ku rezultoi se oferta është anomalisht e ulët.

Në nenin 93 pika 5 Ligjin nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, parashikohet:

“5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

Sa mesiper, oferta juaj refuzohet.

6. “BAJRAMI N.” sh.p.k. me Nipt: K 02727202 O

(Me operator mbështetes: “C O L O M B O” sh.p.k me Nipt: J82916489E, me adrese: Lagjja “Kryengritja e Fierit, ”Rruga “Vangjel Rrushku”, Godina nr.67, Fier, është O.E mbështetës i O.E “BAJRAMI N.” sh.p.k me Nipt: K 02727202 O)

Në përmbushje të kriterit 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim keni deklaruar se drejtues teknik i punimeve në objekt do të jetë ing. F. M.

Ing. F. M. e keni deklaruar si drejtues Teknik të punimeve edhe në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion dhe shtesë anësore 3 kate e shkollës 9 – vjeçare “Naim Frashëri”, lagjja “Kongresi Elbasanit”, procedure, në të cilën jeni shpallur fitues dhe në datë 05.11.2025 keni nënshkruar kontratën me autoritetin kontraktor, Bashkia Elbasan.

Në këtë procedure keni deklaruar se ing. F. M. nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, dhe se në rast se shpallet fitues do të jetë i angazhuar vetëm në këtë kontratë.

Në UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, përcaktohet se: Për projekte me vlerë të plotë të preventivuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

Sa mesiper, ing. F. M. nuk mund të jetë i angazhuar në kontratën objekt prokurimi, duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

Në nenin 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të LPP përcaktohet:

1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi

4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj.

Sa me sipër, oferta juaj refuzohet.

7. “BAMI HOLDING” sh.p.k. me Nipt: J 94416206 R

Operatori ekonomik “BAMI” sh.p.k., nuk ka paraqitur dokumentacionin në afatin e kërkuar siç parashikohet në pikën 6, të nenit 26, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar si dhe në parashikimet e nenit 76 pika 3 germa ë) Ligji nr.162 datë 23.12.2020 ku ndër të tjera thuhet se autoriteti kontraktor s’kualifikon çdo operator i cili nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Sa me sipër, oferta juaj refuzohet.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin : BOE, “EN-SAL” sh.p.k., me nipt: K83520201V, i cili do të realizojë 3.4 % të punimeve dhe me adresë: Vidhas, Papër, Zona Kadastrale Nr. 3764, Numri i Pasurisë 52/26/5, Elbasan & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” sh.p.k., me nipt: K 53002402 C, i cili do të realizojë 96.6 % të punimeve dhe me adresë: Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Asim Vokshi", Alb building 2t, kati i 2, Tiranë, me operator mbështetës: “ALKO-IMPEX General Construcion” dshh me nipt: K91326028I me adresë: Rruga Reshit Petrela, Kompleksi, Usluga, kati i 8, pranë stacionit të trenit, Tiranë, i cili është OE mbështetës i OE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” sh.p.k me nipt: K 53002402 C, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **17,867,843** (shtatëmbëdhjetë milion e teteqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e teteqind e dyzet e tre) **lekë** (pa tvsh) është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan**, Drejtoria e Prokurimeve Publike, rruga "Qemal Stafa", sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr. __ Datë __ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Asim Sula